



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1/2022 (JR)  
Nr. 1/ 2 regj.

Tiranë më 09.01.2025

**SHPALLJE**  
**E**  
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e enjte, **datë 30.01.2025, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, çështja me nr. regjistri (JR) 1/2022, \*datë 05.01.2022, për ankimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Klorinda Çela kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 464, datë 28.10.2021.

Seanca gjyqësore në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor, përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesuese e Trupit Gjyqësor</b>	<b>Ina Rama</b>
<b>Relatore e Çështjes</b>	<b>Mimoza Tasi</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Natasha Mulaj</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Albana Shtylla</b>

Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në zbatim të neneve 133/a dhe 133/b të Kodit të Procedurës Civile ky njoftim do të afishohet në njësinë administrative nr. 9, Bashkia Tiranë.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYQËSOR**  
**GJYQTARE**

**INA RAMA**

